



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 67 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 6 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe nenit 15 paragrafi 15.1 të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 01nr.110-156, të dt.27.01.2011, Komuna e Prishtinës shpallë këtë:

KONKURS

TË BRENDESHËM PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

DREJTORIA E SHËNDETËSISË

POZITA: Zëvendës drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë

KOEFICIENTI : 10.80

LLOJI I POZITËS : Me afat të caktuar (mandat 4 vjeçar)

KATEGORIA FUNKSIONALE: Nivel drejtues

ORARI I PUNËS: 40 orë në javë

PËRGJEGJËSI MBIKËQYRËSE: Po

MBIKËQYRJA: Drejtori i QKMF-së

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

- Siguron Ligjshmërinë dhe punën profesionale në QKMF, e cila duhet të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e Statutit të QKMF-së;
- Është përgjegjës për përkujdesjen efektive të Shëndetësisë parësore për të gjithë banorët e Komunës së Prishtinës;
- Në pajtim me Politikën shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi në Kosovë dhe Strategjinë e Kujdesit parësorë shëndetësorë i propozon Drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë planin e punës dhe buxhetin e QKMF-së, për vitin vijues;
- Kujdeset për zbatimin e planit të burimeve njerëzore;
- Kujdeset për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës;
- Kujdeset për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit të QKMF-së;
- Kontribuon në zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësorë të QKMF-së;
- Ushtron të drejta dhe autorizime dhe mban përgjegjësi të tjera në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet tjera që kanë të bëjnë me implementimin e Mjekësisë Familjare.
- Kryen edhe punë të cilat i cakton drejtori i QKMF-së dhe në mungesë të drejtorit ka të gjitha autorizimet e drejtorit të QKMF-së.

KUSHTET:

- Përgatitje universitare: Fakulteti i Mjekësisë- Specialist i mjekësisë familjare,
- Aftësi të mira analitike dhe komunikuese;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në shëndetësi;
- Të ketë së paku një (1) vit përvojë pune nga fusha e menaxhimit në shëndetësi;
- Aftësi të plotë për përmbushjen e detyrave të vendit të punës, me orar të plotë pa kufizime dhe pengesa ligjore;
- Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme;
- Njohuri të punës me kompjuter;
- Aftësi të tjera që shërbejnë për kryerjen e detyrave të punës dhe raport kolegjal në marrëdhënie të punës.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PER APLIKIM:

- Dokumentet personale;
- Diplomë universitare;
- Licencë pune e lëshuar nga organi kompetent;
- Dëshmi për përvojë pune në shëndetësi;
- Vërtetim mbi gjendjen shëndetësore të lëshuar nga institucioni publik shëndetësore.

Data e shpalljes së Konkursit: 01 / 04 / 2021 deri më 08 / 04 / 2021

Të drejtë konkurrimi kanë vetëm të punësuarit në Institucionin e Komunës së Prishtinës të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim.

Komuna e Prishtinës ofron mundësi të barabarta për të gjithë nëpunësit ekzistues brenda komunës. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe me Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 01nr.110-156, të dt.27.01.2011.

Afati i konkurrimit do të jetë **8 ditë** nga dita e publikimit në web faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës.

Aplikacionet do të merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetarë të Komunës së Prishtinës.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit.

VËREJTJE: Fletë aplikacionet e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, nuk do të merren në shqyrtim, dhe dokumentacioni nuk do të kthehet.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT-ë.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Burimeve Njerëzore në nr. tel: 038/230-900, lok. 10-70, prej orës 08:00 – 16:00 me adresë Komuna e Prishtinës, Rruga UÇK nr. 2, Prishtinë – Republika e Kosovës.